

UDHËZIM
Nr.10, datë 30.3.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE
CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE
PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN
SHKENCOR**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 3.3.2021, nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 19, datë 31.8.2023; nr. 5, datë 21.1.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e elementëve përbërës, formës së diplomës ose certifikatës së lëshuar nga ana e institucioneve të arsimit të lartë (IAL) dhe procedurës së regjistrimit të formës së diplomës dhe certifikatës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe të Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (në vijim Regjistri shtetëror).

2. Forma e secilës diplomë ose certifikatë përpara se të lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë përkatës, duhet të regjistrohet në Regjistrin shtetëror në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA). Ky regjistrim vërtetohet nga dokumenti përkatës i lëshuar nga QShA-ja, i cili përmban bashkëlidhur edhe kopjen e dokumentit të regjistruar. Forma e diplomës ose certifikatës përcaktohen sipas përmbajtjes së shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin me dokumentin zyrtar përkatës, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, studentin i cili ka përfunduar detyrimet akademike dhe detyrime të tjera institucionale për programin përkatës të studimit.

4. Diploma ose certifikata lëshohet si rregull në gjuhën shqipe. Përgjatimisht, në rastin e diplomave të përbashkëta, të dyfishta ose të shumëfishta me një ose më shumë institucione të huaja të arsimit të lartë si dhe në rastin programeve të hapura në gjuhë të huaj ose të diplomave ose certifikatave të IAL-ve të huaja, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit që ato zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë, diploma ose certifikata lëshohet në njëërën nga 5 (pesë) gjuhët e Bashkimit Evropian, konkretisht në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, në përputhje me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit/aktin e miratimit të hapjes së programit.

5. Regjistri Shtetëror është një bazë unike të dhënash e të gjitha formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuara në përputhje me legjislacionin në fuqi nga institucionet e arsimit të lartë.

6. Regjistri shtetëror mbahet dhe ruhet në formë të shkruar dhe elektronike.

7. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja elektronike e të dhënave të depozituara në regjister kryhet nëpërmjet një sistemi të informatizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Regjistrat e shkruar trajtohen sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat". QShA administron dhe ruan dokumentet shoqëruese të paraqitura nga IAL-të.

9. IAL-të kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë të gjitha format e diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror përpara datës së lëshimit të tyre, në të kundërt konsiderohen të pavlefshme.

10. Çdo diplomë ose certifikatë që lëshohet nga IAL-të, duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

KREU II

ELEMENTËT PËRBËRËS TË FORMËS SË DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS

1. Elementët e detyrueshëm, që duhet të përmbajë çdo diplomë ose certifikatë, janë si më poshtë:
 - a) Stema dhe emërtimi “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” me germa të mëdha;
 - b) Stema e institucionit përkatës të arsimit të lartë;
 - c) Lloji dhe emri i IAL-së, me germa të mëdha në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe dokumentit të hapjes/riorganizimit të tij;
 - ç) Emri i njësisë kryesore që ofron programin e studimit, me germa të mëdha dhe stemën përkatëse (nëse ka). Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një IAL-je vendoset emri i njësisë bazë që ofron programin e studimit, me gema të mëdha dhe stemën përkatëse nëse ka;
 - d) Emërtimi i diplomës ose certifikatës, sipas përcaktimit në aktin e hapjes/riorganizimit të programit të studimit, i shkruar me germa të mëdha;
 - i. *Shfuqizuar*;
 - ii. “Certifikatë Profesionale” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - iii. Diplomë “Bachelor” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - iv. Diplomë “Master profesional” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - v. Diplomë “Master i shkencave” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - vi. Diplomë “Master i arteve” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - vii. “Master i shkencave” në “fusha e arsimimit të kryer” për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë;
 - viii. “Master ekzekutiv” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - ix. Diploma e Gradës Shkencore “Doktor” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - x. “Diplomë specializimi” në “fusha e arsimimit të kryer”;
 - xi. “Certifikatë” në “fusha e arsimimit të kryer”.
 - dh) Numri i krediteve (ECTS), në përputhje me përcaktimet në aktin e hapjes/riorganizimit.
 - Për certifikatat e lëshuara në përfundim të programit të studimit të formimit të vazhduar/kualifikimit të ofruara nga IAL-të për të nxënëit gjatë gjithë jetës, ECTS shënohen vetëm në rastet kur në dokumentin e hapjes dhe akreditimit janë përcaktuar ECTS-të dhe kur këto kualifikime janë përfshirë në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Për programet e studimit të formimit të vazhduar mund të shënohet dhe numri i krediteve të formimit në vazhdim sipas aprovimit përkatës nga institucioni i arsimit të lartë;
 - e) Niveli përkatës në KSHK, i shprehur me shifra arabe dhe siglën KSHK-së. Për certifikatat e lëshuara në përfundim të programit të studimit të formimit të vazhduar/kualifikimit, të ofruara nga IAL-të për të nxënëit gjatë gjithë jetës, niveli shënohet vetëm kur këto kualifikime janë përfshirë në KSHK;
 - ë) Emri, atësia (në rastet kur nuk ka atësi në certifikatën e lindjes, ajo lihet bosh) dhe mbiemrin e studentit para martesës si dhe në kllapa mbiemri që mban në momentin e diplomimit (nëse është i ndryshëm);
 - f) Vendi dhe data e lindjes;
 - g) Data e lëshimit të diplomës ose certifikatës;
 - gj) *Emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shkrim dore. Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një IAL-je vendoset emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shkrim dore.*
 - h) Numri i matrikullimit të studentit. Kjo pikë nuk aplikohet për programet e studimit të formimit të vazhduar/ kualifikimit, për të nxënëit gjatë gjithë jetës, të ofruara nga IAL-të;

i) Data e regjistrimit të studentit në institucionin që lëshon diplomën për programin përkatës të studimit;

j) Data e përfundimit të studimeve (të shlyerjes së detyrimeve akademike, mbrojtje diplome/provim përfundimtar);

k) Tema e tezës së diplomës (vetëm në rastet e studimeve të doktoratës);

l. Forma e studimeve dhe kohëzgjatja normale e programit të studimit;

ll) Numri unik i identifikimit të diplomës i lëshuar nga QShA/MASR në momentin e regjistrimit të formës së diplomës;

m) Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve në diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/ numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njësimin të diplomës, për diplomat që janë lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe ID e Maturës Shtetërore/ numri i dokumentit të njëvlershmërisë së dëftesës/ diplomës së arsimit të mesëm të lartë që është lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë (numri i regjistrimit të veçantë për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2006) në diplomat “Bachelor”, diplomat ose certifikatat profesionale dhe diplomat “Master i shkencave” të programeve të integruara të studimeve;

n) Numri i diplomës për studimet e ciklit të parë dhe për diplomat e ciklit të dytë e të tretë, numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë / numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njohjes dhe njësimin të diplomës/ certifikatës së lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë.

nj) Numri dhe data e Vendimit të Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”;

o) Numri në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë për diplomën përkatëse të Gradës Shkencore “Doktor”.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Senatet akademike miratojnë formulimin grafik dhe përmbajtjen e diplomave, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi, përfshirë elementët e sigurisë.

3. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato “Master Ekzekutiv” të ciklit të tretë, shoqërohen me suplementin e diplomës që është pjesë e pandarë e diplomës dhe lëshohet së bashku me të konform përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Në pjesën e poshtme të diplomës vihet shënimi “Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj”.

4. Në rastin e diplomave ose certifikatave të përbashkëta, të dyfishta ose të shumëfishta me një ose më shumë institucione të huaja të arsimit të lartë, ato përmbajnë jo të gjitha elementët e parashikuar në pikat 1, 2, dhe 3 të këtij kreu. Në këto raste, elementët në germet a), b), c), d), dh), e), ë) f), g), j) të pikës 1, të këtij kreu, duhet të jenë pjesë e këtyre diplomave ose certifikatave, forma dhe përmbajtja e të cilave përcaktohet me marrëveshje mes IAL-ve, për programin përkatës të studimit.

5. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të e huaja, në përputhje me përcaktimet e pikës 5, të nenit 35, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, diploma dhe suplementi përkatës lëshohet nga IAL-ja e huaj, e cila në suplement specifikon vendin e ofrimit të studimeve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në kuadrin ligjor shqiptar për këtë program studimi.

6. Diplomat lëshohen nga IAL-të përkatëse, brenda afatit 3 - mujor, por në çdo rast, jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të detyrimeve akademike e institucionale dhe plotësimit të kërkesave ligjore nga ana e studentit, për programin përkatës të studimit.

7. IAL-të nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit (vërtetim diplome) i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.

8. IAL-ja ruan në arkivën e tij fotokopje të diplomës origjinale dhe kopje të digjitalizuar të diplomës që i lëshohet studentit.

KREU III

PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E FORMËS SË DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS NË REGJISTRIN SHTETËROR

1. *Regjistrimi fillestar i formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuar nga IAL, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit të IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.*

2. Aplikimi për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës shqyrtohet nga QSHA-ja. Formulari për regjistrimin e formës së diplomës, i nënshkruar prej rektorit të IAL-së, shoqërohet me:

a) vendimin e Senatit Akademik, shoqëruar me formën e miratuar të diplomës apo certifikatës që do të regjistrohet, si dhe suplementin e diplomës (nëse ka);

b) mandatpagesën për tarifën e regjistrimit në regjistrin shtetëror.

QSHA-ja siguron nëpërmjet ndërveprimit me institucionet përgjegjëse dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopjen e statutit të IAL-së të miratuar dhe aktin e miratimit të tij;

b) kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) dhe kopjen e aktit të akreditimit të IAL-së ose kur afati i akreditimit ka përfunduar, kopjen e dokumentit, me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik institucional;

c) kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma, që regjistrohet dhe kopjen e aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma që regjistrohet, ose kopjen e dokumentit me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik të programit të studimit, me përjashtim të programit të studimit për të cilin legjislacioni në fuqi nuk parashikon akreditimin e tij.

3. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të vërtetuara në gjuhën shqipe dhe të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi.

4. QSHA-ja kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumenteve të paraqitura në dosjen e aplikimit, brenda një afati 45-ditor nga data e depozitimit të aplikimit.

5. QSHA-ja pasi kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit në dosjen e aplikimit dhe kur konstaton se IAL-ja dhe programi i studimit përmbushin kriteret për lëshimin e diplomës ose certifikatës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, regjistron formën e diplomës ose certifikatës.

6. QSHA-ja kryen regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës në Regjistrin shtetëror dhe lëshon vërtetimin përkatës me vullë elektronike për IAL-në. Ky vërtetim i dërgohet IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.

7. Vërtetimi i regjistrimit lëshohet brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së aplikimit.

8. Në rast se pas verifikimeve, rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat për regjistrim, të parashikuara në këtë udhëzim, QSHA-ja pezullon aplikimin dhe njofton IAL-në në portalin unik qeveritar e-Albania, për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Afati i procedurës së regjistrimit rifillon ditën pasardhëse të plotësimit ose ndreqjes së këtyre elementeve, në portalin unik qeveritar e-Albania.

9. QSHA-ja refuzon regjistrimin në rastet kur:

a) Aplikimi nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e vendosura në këtë udhëzim;

b) Të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga dokumentet e paraqitura.

10. Refuzimi i aplikimit, i cili përmban shkakun e refuzimit, i njoftohet IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.

11. IAL-ja ruan të drejtën e një aplikimi të ri për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës, nëse ai është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12. Të dhënat që do të mbahen në Regjistrin shtetëror për çdo diplomë ose certifikatë do të jenë:

a) Emërtimi i IAL-së në përputhje me aktin e hapjes (apo të riorganizimit institucional);

b) Lloji i IAL-së, e cila lëshon diplomën/certifikatën: Universitet, Kolegj Universitar, Akademi dhe Kolegj Profesional i Lartë;

c) Numri dhe data e aktit të hapjes dhe të akreditimit të IAL-së, e cila lëshon diplomën ose certifikatën;

ç) Numri dhe data e aktit të hapjes dhe të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma ose certifikata;

d) Adresa e vendndodhjes së IAL-së;

dh) Numri unik i identifikimit të diplomës ose certifikatës;

e) Numri dhe data e aktit të miratimit të formës konkrete të diplomës.

13. Çdo formë diplome ose certifikate, e regjistruar në Regjistrin shtetëror, pajiset me një numër unik identifikimi.

14. Numri unik i identifikimit është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

15. IAL-të janë të detyruara që të shënojnë numrin unik të identifikimit në diplomat ose certifikatat që ato lëshojnë.

16. Diplomat ose certifikatat e regjistruara në Regjistrin shtetëror vlerësohen të njohura dhe përbëjnë akte zyrtare për të gjitha autoritetet që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

17. QSHA-ja publikon listën me format e diplomave dhe certifikatave të regjistruara në faqen e saj zyrtare të internetit.

18. Regjistrimi fillestar dhe regjistrimi i mëvonshëm i çdo forme diplome ose certifikate i nënshtrohet tarifës së regjistrimit.

19. Tarifa e regjistrimit do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë për çdo formë diplome dhe certifikate të regjistruar, për llogari të QSHA-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

20. Çdo IAL e interesuar, të cilës i është refuzuar regjistrimi i formës së diplomës ose certifikatës, ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ brenda 30 ditësh në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

21. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë pasi shqyrton ankimin e depozituar, merr vendim dhe ia njofton IAL-në e interesuar brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

22. IAL-ja e interesuar ka të drejtë të ankimojë vendimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë -së në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

23. Çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë lëshimin e ekstrakteve për formën e diplomës ose certifikatës së regjistruar në Regjistrin shtetëror.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 5, datë 18.2.2009, “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar” dhe udhëzimi nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, shfuqizohen.

1/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

Shtojca nr.1

Formimi i numrit unik të identifikimit

U	T	0	0	1	6	0	0	0	0	0	1
IAL		Programi i studimit			Cikli	Viti Regj.		Numri rendor			

1. Kodi i IAL-së përbëhet nga dy shkronja, të cilat vendosen në mënyrë unike.

2. Programi i studimit përbëhet nga tri shifra.

3. Cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

4. Viti i regjistrimit përbëhet nga dy shifra, të cilat tregojnë vitin e regjistrimit, ku 17 tregon vitin 2017.

5. Ky numër shtohet me 1, për çdo vit.

6. Numri rendor përcaktohet nga sistemi në rend rritës.